



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Avokatura Istrefi & Osmani” Sh.P.K. të datës 22.04.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 15.04.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Shërbimet e përfaqësimit, avokaturës dhe procedurave të ndërmjetësimit” me nr. të prokurimit 616-24-599-2-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

**V E N D I M**

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Avokatura Istrefi & Osmani” Sh.P.K. e datës 22.04.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 29.03.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Shërbimet e përfaqësimit, avokaturës dhe procedurave të ndërmjetësimit” me nr. të prokurimit 616-24-599-2-1-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik “Avokatura Istrefi & Osmani” Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Operatori ekonomik “Avokatura Istrefi & Osmani” Sh.P.K. (tutje “parashtruesi”) me datë 22.04.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 15.04.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Shërbimet e përfaqësimit, avokaturës dhe procedurave të ndërmjetësimit” me nr. të prokurimit 616-24-599-2-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit:

- **Pretendimi nr. 1:** "AK në dosjen e tenderit ka paraparë kapacitetin teknik dhe financiar, të cilin kriter Grupi i Operatorëve Ekonomik i shpallur fitues: "Pro Juris Law Firm" L.L.C. dhe "Tahiri & Partners" Sh.P.K. nuk e plotësojnë. GOE ka dorëzuar Deklaratën Vjetore CD për vitet 2021-2023 mirëpo nuk ka dorëzuar Gjendjen Tatimore për këto vite".
- **Pretendimi nr. 2:** "GOE fitues, gjegjësisht lideri i këtij grupi "Pro Juris Law Firm" L.L.C. i ka të punësuar 3 avokat, por jo 4 siç ishte kërkuhet me dosjen e tenderit. Kriter kryesor i AK-së ka qenë që Shoqëria e Avokatëve të ketë të punësuar së paku 4 avokatë dhe pastaj kjo Shoqëri mund të lidhë konzorcium me avokat për përmbushjen e kriterëve të tjera".

**Lidhur me pretendimin nr. 1** - kërkesa e dosjes së tenderit të cilës i referohet ky pretendim ankimor është formuluar në dosjen e tenderit si në vijim:

OE-ik duhet te ofroj dëshmi te kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i OE-ik , gjate tri viteve te fundit ka qene jo me pak se 350,000.00 euro	Deklaratat e dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës apo ne vendin e themelimit apo Kopjet e raporteve financiare dhe raporteve të menagjimit të certifikuara nga një firmë e njohur e licencuar për kontrollim apo një auditor i licencuar i
---	--

Në ofertën e tenderuesit të rekomanduar ndër të tjera është gjetur se që të dy anëtarët e GOE kanë dorëzuar edhe deklaratat në ATK sikurse është kërkuar me dosjen e tenderit. Për më tepër, pas kërkesës së AK, tenderuesi i rekomanduar ka dorëzuar edhe vërtetimet tatimore me vlefshmëri kohore. Përmes deklaratave tatimore të dorëzuara në ATK të mbështetura edhe nga vërtetimet tatimore është konfirmuar se GOE i rekomanduar për kontratë ka ofruar dëshmi të kënaqshme se gjatë tri viteve të fundit para publikimit të njoftimit për kontratë qarkullimi vjetor ka qenë dukshëm mbi 350,000.00 euro.

Sa i përket pikës së pretendimit ankimor se deklaratat e dorëzuara në ATK nuk janë dokumente të besueshme, duhet cekur se në dosjen e tenderit janë kërkuar pikërisht deklaratat e dorëzuar tatimore në ATK. Vlen të thuhet se çdo tenderues me rastin e ofertimit detyrohet që të dorëzojë edhe një deklaratë nën betim lidhur me vërtetësinë e dokumenteve të bashkangjitura në ofertë. Prandaj për autoritetin kontraktues deklaratat e dorëzuara nga OE apo GOE në ATK trajtohen si dëshmi e kënaqshme respektivisht dokumente të besueshme jo vetëm për këtë aktivitet të prokurimit, por pothuajse për të shumicën absolute të aktivitetëve të prokurimit që zhvillohen nga Komuna e Prishtinës si autoritet kontraktues. Prandaj as ky aktivitet i prokurimit nuk përbën përjashtim.

Sa i përket pikës së pretendimit ankimor se tenderuesi i rekomanduar nuk ka dorëzuar gjendjen tatimore përkatësisht gjendjen e përgjithshme të deklarimeve dhe transaksioneve të tjera nga ATK, duhet theksuar sërish faktin se ky dokument nuk është kërkuar me dosjen e tenderit. Paradoksi në këtë rast ekziston për shkak të faktit se as vet parashtruesi nuk e ka dorëzuar gjendjen tatimore të cilës i referohet në kërkesë për rishqyrtim. Në fakt parashtruesi ka dorëzuar vërtetimin tatimor njëlloj sikurse edhe tenderuesi i rekomanduar për kontratë, mirëpo për dallim parashtruesi nuk i ka dorëzuar edhe deklaratat tatimore për tri vitet e fundit të dorëzuara në ATK sikurse është përcaktuar me dosjen e tenderit.

Sa i përket pikës së pretendimit ankimor për gjendjen tatimore, përderisa nuk është kërkuar në mënyrë specifike dorëzimi i një dokumenti të tillë, as parashtruesi por as vet autoriteti kontraktues nuk mund të interpretojnë kërkesat e dosjes së tenderit në këtë fazë dhe aq më pak të interpretojnë kërkesat në disfavor të operatorëve të caktuar ekonomik. Kjo do të ishte posaqërisht në kundërshtim me parimin për mosdiskriminim dhe mosfavorizim në kuptim të nenit 7 të LPP. Në rastin konkret kërkesa e dosjes së tenderit ka qenë e formuluar në mënyrë shumë të saktë dhe të kuptueshme në përputhje të plotë me nenin 27, 28, *et.al.* të LPP. Sidoqoftë parashtruesi apo kushdo tjetër kanë pasur mundësi që të sqarojnë paqartësitë e tyre eventuale lidhur me kërkesat e dosjes së tenderit para hapjes së ofertave.

Sidoqoftë, pretendimi ankimor si i tillë është i pabazuar në tërësi ndërsa GOE i rekomanduar për kontratë ka përmbushur të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit ashtu siç janë përcaktuar nga autoriteti kontraktues.

**Lidhur me pretendimin nr. 2** – kërkesa e dosjes së tenderit të cilës i referohet ky pretendim ankimor është formuluar në dosjen e tenderit si në vijim:

<b>Të jetë shoqëri e avokatëve konform nenit 27 par. 1 nënpar. 1.3 dhe nenit 30 të Ligjit nr. 04/L-193 për Avokatinë për së paku një (1) vit me të paktën katër (4) avokat me licencë nga Oda e Avokatëve të Kosovës.</b>	<b>Një kopje të vendimit nga Oda e Avokatëve të Kosovës dhe Licencat për avokatët.</b> <b>Nëse shoqëria ka angazhuar avokatë shtesë për këtë aktivitet të prokurimit, atëherë duhet të dorëzohen edhe marrëveshjet për angazhim të avokatëve nga Shoqëria.</b>
---	---

Në ofertën e tenderuesit të rekomanduar është gjetur se lideri i grupit të operatorëve ekonomik është shoqëri e avokatëve për më gjatë se një (1) vit dhe ka në dispozicion katër (4) avokatë të licensuar nga OAK. Me këtë rast është dorëzuar një kopje e vendimit të OAK për formimin e shoqërisë së avokatëve si dhe licencat e katër (4) avokatëve përkatës, prej të cilëve tre (3) janë pjesë e OE "Pro Juris Law Firm" si lider i GOE dhe një (1) avokat tjetër është pjesë e OE "Tahiri & Partners" si anëtar i GOE me të cilin njëkohësisht shoqëria e avokatëve ka lidhur marrëveshje për angazhim sikurse është përcaktuar me dosjen e tenderit. Vlen të theksohet fakti që në dosjen e tenderit është shënuar saktësisht që "nëse shoqëria ka angazhuar avokatë shtesë për këtë AP, atëherë duhet të dorëzohen edhe marrëveshjet për angazhim të avokatëve nga shoqëria". Në rastin konkret tenderuesi i rekomanduar ka dorëzuar edhe një listë me katër (4) avokatë ku njëri prej tyre është edhe me marrëveshje për angazhim sipas dosjes së tenderit por edhe anëtar i GOE sipas marrëveshjes për themelimin e GOE. Në këtë mënyrë është plotësuar në mënyrë të plotë kërkesa e dosjes së tenderit për të cilën po bëhet fjalë.

Sa i përket pjesës së pretendimit ankimor ku thuhet se për të përmbushur këtë kërkesë të dosjes së tenderit nuk lejohet themelimi i grupit të operatorëve ekonomik, fillimisht duhet cekur se themelimi dhe tenderimi nga grupi i operatorëve ekonomik është rregullur përmes nenit 71 të LPP dhe nenit 26 të RRPP. Askund në LPP apo në RRPP nuk thuhet se për një kërkesë të tillë nuk lejohet tenderimi përmes grupit të operatorëve ekonomik. Në anën tjetër as përmes dosjes së tenderit nuk është përcaktuar që për këtë kërkesë nuk lejohet tenderimi për GOE. Mirëpo edhe po të ishte kësajsoj, sërish duhet

potencuar faktin se shoqëria e avokatëve “Pro Juris Law Firm” dhe avokati A.T. kanë dorëzuar marrëveshje të vlefshme për angazhim pikërisht për këtë aktivitet të prokurimit, saktësisht sikurse është përcaktuar me dosjen e tenderit të cituar më sipër. Pra nga cilido këndvështrim i mundshëm, tenderi i rekomanduar ka dëshmuar më shumë se mjaftueshëm se ka në dispozicion katër (4) avokatë të licensuar nga OAK saktësisht sikurse është kërkuar përmes dosjes së tenderit. Rrjedhimisht tenderuesi i rekomanduar e ka përmbushur në mënyrë të plotë edhe këtë kërkesë të dosjes së tenderit ndërsa pretendimi ankimor është i pabazuar në tërësi.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Prishtinë, 25.04.2024**

**Visar SHEHU**  
  
Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës

**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.